

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6220
E premte, 22 janar 2021
çmimi 0.40 €

Liderët e Ballkanit urojnë Bidenin

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA DHE SHOQËRIA CIVILE KUNDËRSHTOJNË PRESIONIN POLITIK NDAJ KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) DHE KRYETARES VALDETE DAKA

FAQE 4-5

DAKA: KËRCËNIMET NDAJ MEJE JANË TË RREZIKSHME

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije të enjten se kërcënimet publike ndaj saj janë të paprecedenta. Në një konferencë për media mbajtur të enjten, ajo ka thënë se akuzat e partive politike ndaj saj dhe KQZ-së janë ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e këtij institucioni të pavarur. Presionin politik ndaj KQZ-së dhe kryetares së saj e kanë dënuar edhe kryeministri në detyrë Avdullah Hoti dhe shoqëria civile. Ata i kanë ftuar partitë politike të përmbahen dhe të mos bëjnë presion mbi institucione të pavarura



AKTUALE

**STANDARDI I PARTIVE POLITIKE,
KANDIDATËT ME PROBLEME
LIGJORE** F. 8

**NJË MILION EURO PËR
KOMPENSIMIN E DËMEVE NGA
VËRSHIMET NË KOSOVË** F. 8

**EDHE SHTATË TË VDEKUR DHE
296 RASTE TË REJA ME COVID
NË KOSOVË** F. 3



EKONOMI

**13.4 MILIONË EURO PËR HYRJEN
E FERIZAJT ME KATËR KORSI** F. 9

**PARLAMENTI EVROPIAN
KËRKON NDALJEN E PROJEKIT
TË GAZSJELLËSIT RUS
"NORD STREAM II"** F. 8



SPORT

**DISTRIA NGA SHTATORI
I 2018-S KA FITUAR MEDALJE
NË ÇDO GARË** F. 12



SHËNOHET DYVJETORI I LANSIMIT TË PLANIT GJITHËPËRFSHIRËS TË TRANZICIONIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS (FSK)

PËRMBYLLET ME SUKSES VITI I DYTË I TRANZICIONIT TË FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneraljetnani Rrahman Rama, ka thënë se dyvjetori i lansimit të planit gjithëpërfshirës i tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) shënon kalimin nga një fazë administrative, doktrinare dhe konceptuale në një fazë të ndërtimit të aftësive teknike, taktike dhe luftarake në nivel të njësisë operacionale. Ndërkaq ministri në detyrë i Mbrojtjes, Anton Quni, ka theksuar se gjatë kësaj periudhe kanë arritur që ta realizojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve sa i përket planit të tranzicionit të FSK-së

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni shfuqizon disa vendime të Trumpit



UASHINGTON, 21 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka nënshkruar disa urdhra ekzekutivë që zhbëjnë disa politika të paraardhësit të tij, Donald Trump. Urdhri i parë i tillë e bën të detyrueshme veshjen e maskës nga punonjësit federalë si masë për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Me urdhrat e tjerë të nënshkruar nga Biden, mes të tjerash, ndalohet ndërtimi i murit në kufirin e ShBA-së me Meksikën, hiqen ndalesat e udhëtimit nga disa vende kryesisht me shumicë myslimane, si dhe anulohet vendimi për tërheqjen e ShBA-së nga Marrëveshja e Parisit për Klimën. “Nuk ka kohë për të humbur kur bëhet fjalë për t'i trajtuar krizat me të cilat përballlemi”, ka shkruar Bideni në “Twitter”, kur u drejtua për në

Shtëpinë e Bardhë pas inaugurimit të tij.

Pas hyrjes në Shtëpinë e Bardhë, Bideni ka theksuar se paraardhësi i tij, Donald Trump, i kishte lënë një letër shumë bujare. “Meqenëse ishte private, nuk do të flas për këtë derisa të flas me të. Por, ishte letër bujare”, ka thënë Bideni.

Demokrati Joe Biden u inaugurua të mërkurën si presidenti i 46 i Shteteve të Bashkuara.

Kamala Harris, po ashtu, bëri betimin për zëvendëspresidente. Biden, 78 vjeç, është presidenti më i vjetër amerikan që merr detyrën. Ai i ka fituar zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit 2020 kundrejt republikanit Donald Trump.

Kongresi e ka miratuar fitoren e tij më 6 janar.

Trump nuk mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit.

Liderët e Ballkanit urojnë Bidenin

PRISHTINË, 21 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, i ka dërguar telegram urimi presidentit të ShBA-së, Joe Biden. “Jam shumë i lumtur të theksoj se Republika e Kosovës ka marrëdhënie shumë të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në historinë e fundit të Kosovës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë luajtur një rol vendimtar”, thuhet, ndër të tjera, në telegram.

Kryeministri në detyrë, Hoti, e ka siguruar presidentin Biden se Qeveria e Republikës së Kosovës, të gjitha partitë e saj politike, pozita dhe opozita, janë plotësisht të përkushtuara për t'i kultivuar dhe forcuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Unë jam i përkushtuar të punoj me administratën tuaj për t'i forcuar institucionet demokratike, integrimin Euro-Atlantik dhe për t'u bërë një bartës i stabilitetit”, thuhet në letër.

Hoti, me këtë rast, ka shprehur falënderimet dhe mirënjohjet për presidentin Donald Trump dhe administratën e tij për mbështetjen e dhënë për proceset demokratike në Kosovë dhe integrimet ekonomike

rajonale.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ftoi presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, që ta vizitojë Serbinë. Në urimin e tij drejtuar Bidenit, pas inaugurimit të tij presidenti i 46 i Shteteve të Bashkuara, Vuçiq kujtoi se këtë vit shënohet 140-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Serbisë dhe Shteteve të Bashkuara. “Deri më tani janë shënuar përvjetorë të rëndësishëm nga historia e përbashkët, duke kujtuar shembuj të aleancës mes dy vendeve në anën e së vërtetës dhe drejtësisë”, ka thënë Vuçiqi. Këta shembuj, sipas tij, “ka qenë një nxitje për Serbinë, që të përpiqej t'i kthejë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara në nivelin e një partneriteti të vërtetë, me gjithë gjurmët nga kohët e keqkuptimit dhe mosmarrëveshjeve”.

Edhe presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanović, e uroi presidentin amerikan me dëshirën për sukses për përmbushjen e detyrave të tij. “Dua t'ju siguroj se Malin e Zi do ta keni mik të sinqertë, partner të



besueshëm dhe aleat të përgjegjshëm në përballje me sfidat komplekse globale dhe çështjet e hapura në Ballkanin Perëndimor”, thuhet në urimin e presidentit Gjukanović.

Anëtar i presidencës trepalëshe o Bosnjë dhe Hercegovinës, Shefik Xhaferović, ka thënë se

inaugurimi i Bidenit ngjall shpresën “jo vetëm të kombi i madh amerikan, por të gjithë njerëzit me qëllime të mira në të gjithë botën”.

Ndërsa presidenti kroat Zoran Millanović ka theksuar, pas inaugurimit të Bidenit, se i vjen mirë që “besimi për një dritë në

fund të tunelit prapëseprapë triumfon atje”. Si senator, Bideni ka qenë aktiv në Ballkanin Perëndimor dhe ka vizituar këtë rajon në disa raste. Hera e fundit që Bideni ka vizituar Kosovën dhe Serbinë, si zëvendëspresident i Shteteve të Bashkuara, ka qenë në gusht të vitit 2016.

Gjermania paralajmëron mbylljen e kufijve me fqinjët

BERLIN, 21 JANAR - Gjermanisë mbase do t'i duhet t'i mbyllë kufijtë me vendet fqinje, nëse ato nuk marrin masa për ta frenuar përhapjen e Covid-19. Kështu ka thënë të enjten shefi i stafit të kancelares gjermane Angela Merkelit, Helge Braun.

Ai ka deklaruar për televizionin ARD, se është e rëndësishme të vendoset nën kontroll situata në mënyrë që vendet ta mbrojnë veten nga varianti i ri i Covid-19, shumë më i transmetueshëm. “Rreziku është që kur numri i

të infektuarve në një vend të rritet, ky mutacion i virusit bëhet dominues dhe atëherë infeksioni nuk mund të kontrollohet më”, ka thënë ai, duke shtuar se rregullat më të rrepta të hyrjes në Gjermani janë të pashmangshme.

Që nga muaji nëntor 2020 Gjermania ka vendosur masa të ashpra të izolimit duke mbyllur restaurantet dhe qendrat e sportit, ndërsa prej mesit të dhjetorit edhe shkollat dhe shumicën e dyqaneve.



Shënohet dyvjetori i lansimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

Përmbillet me sukses viti i dytë i tranzicionit të FSK-së

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka thënë se dyvjetori i lansimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) shënon kalimin nga një fazë administrative, doktrinare dhe konceptuale në një fazë të ndërtimit të aftësive teknike, taktike dhe luftarake në nivel të njësive operacionale. Ndërkaq ministri në detyrë i Mbrojtjes, Anton Quni, ka theksuar se gjatë kësaj periudhe kanë arritur ta realizojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve sa i përket planit të tranzicionit të FSK-së

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Në Kazermën "Adem Jashari" të enjten u organizua ceremonia e përmbylljes së vitit të dytë të tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në këtë ceremoni morën pjesë ministri në detyrë i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, drejtori i NALT-it, gjenerali Frank Best, gjeneralë dhe oficerë të lartë

të FSK-së, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues të NALT-it, atashe dhe këshilltarë ushtarakë ndërkombëtar.

Në fjalën e tij, ministri Quni, pasi ka përshëndetur të pranishmit, i ka uruar për sukseset e arritura gjatë realizimit të planit dyvjeçar të tranzicionit të FSK-së. "Sot shënojmë dyvjetorin e lansimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, andaj ndihem krenar dhe i privilegjuar, që si ministër i Mbrojtjes të

konstatoj se gjatë kësaj periudhe kemi arritur ta realizojmë pjesën më të madhe të aktiviteteve për këtë periudhë planifikuese, e në disa fusha e komponentë, edhe t'i tejkalojmë ato", ka thënë Quni, duke shtuar se, krahas këtyre sukseseve, brenda kësaj periudhe është avancuar sistemi i duhur i hartimit dhe zbatimit të politikave

të mbrojtjes në fushën e planifikimit, programimit, modernizimit e standardizimit të forcave, bashkëpunimit ndërkombëtar e integrimi euroatlantike, inteligjencës dhe sigurisë, sistemit të integruar të burimeve materiale, infrastrukturore e mbështetjes logjistike.

Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, ka thënë se kjo ditë shënon kalimin nga një fazë administrative, doktrinare dhe konceptuale në një fazë të ndërtimit të aftësive teknike, taktike dhe luftarake në nivel të njësive operacionale. "Konsideroj se pa marrë parasysh sfidat me të cilat jemi përballë, si: tërmeti në Shqipëri, pandemia globale, përmbytjet dhe shkurtimet e vazhdueshme buxhetore, ne kemi arritur që jo vetëm t'i përmbushim detyrat e parapara në këtë fazë, por edhe t'i tejkalojmë pritshmëritë tona", ka

thënë Rama.

Ndërsa drejtori i NALT-it, gjenerali Frank Best, ka përgëzuar Ministrinë dhe FSK-në. "Ju përgëzoj për atë që është arritur deri më tani. Veçanërisht ju përgëzoj për qasjen tuaj transparente, angazhimin tuaj për mbikëqyrjen civile, qasjen tuaj multietnike dhe theksin mbi drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Ishte nder dhe gëzim për të gjithë ne, në NALT, t'ju ndihmojmë dhe t'ju këshillojmë mbi hapat e ndërmarrë me të gjitha mjetet dhe aftësitë që kemi në dispozicion. NALT-i do të vazhdojë të jetë në krahun tuaj. Ne do të qëndrojmë të përkushtuar ndaj mandatit tonë për këshilla, lidhje dhe trajnime", ka thënë Best.

Ceremonia u përmbyll me nënshkrimin e dokumenteve doktrinare nga komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, që janë bazë e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.



Edhe shtatë të vdekur dhe 296 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 569 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 296 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar shtatë raste të të

vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan një rast (91 vjeç), Ferizaj një rast (40 vjeç), Istog një rast (73 vjeç), Prizren një rast (79 vjeç), Rahovec një rast (42 vjeç), Viti një rast (72 vjeç), Vushtrri një rast (81 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 57 028 raste nga 214 941 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 433 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 202 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 50 184 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5

411.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 60 raste, Podujevë 26 raste, Mitrovicë 25 raste, Suharekë 25 raste, Gjilan 18 raste, Vushtrri 18 raste, Ferizaj 16 raste, Gjakovë 16 raste, Prizren 15 raste, Malishevë 12 raste, Fushë-Kosovë 9 raste, Lipjan 9 raste, Deçan 7 raste, Rahovec 7 raste, Pejë 6 raste, Klinë 5 raste, Skenderaj 5 raste, Viti 4 raste, Drenas 3 raste, Graçanicë 2 raste, Istog 2 raste, Obiliq 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash dhe Kaçanik.



AMBULANCA PËR
CORONAVIRUS



QEVERIA DHE SHOQËRIA CIVILE KUNDËRSHTOJNË PRESIONIN POLITIK NDAJ KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) DHE KRYETARES VALDETE DAKA

Daka: Kërcënimet ndaj meje janë të rrezikshme

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije të enjten se kërcënimet publike ndaj saj janë të paprecedenta. Në një konferencë për media mbajtur të enjten, ajo ka thënë se akuzat e partive politike ndaj saj dhe KQZ-së janë ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e këtij institucioni të pavarur. Presionin politik ndaj KQZ-së dhe kryetares së saj e kanë dënuar edhe kryeministri në detyrë Avdullah Hoti dhe shoqëria civile. Ata i kanë ftuar partitë politike të përmbahen dhe të mos bëjnë presion mbi institucione të pavarura

që nuk plotësojnë kriterin për t'u certifikuar kandidat për deputet, do t'u them vetëm dy fjalë shkurt, shqip dhe qartë: Është ligji dhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese që jua pamundëson kandidimin, jo unë", është shprehur Daka, duke shtuar se ajo nuk e ka shkruar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as nuk e ka votuar. "Unë nuk e kam shkruar as nenin 29 të këtij ligji. Nuk e kam shkruar as germën Q të këtij neni që pamundëson kandidimin e një personi i cili është shpallur fajtor për veprën penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre vjetët e fundit. Unë nuk e kam shkruar as Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që kërkon zbatimin e kësaj dispozite ligjore", ka thënë e para e KQZ-së. Më tej, ajo ka ftuar kandidatët

që mendojnë se në këtë proces po u bëhet e padrejtë, të ankojnë. Ajo është zotuar se si kryetare e këtij institucioni do ta zbatojë në përpikëri këtë aktgjykim. "Çdo person që mendon se po i bëhet e padrejtëdo të mund të ankohet në institucionet si PZAP apo edhe në Supreme. Ne do t'i zbatojmë vendimet e tyre. Unë, Valdete Daka, nuk i kam shkruar dhe as votuar këto ligje, por si gjyqtare dhe si drejtuese e KQZ-së i garantoj qytetarët e Republikës së Kosovës se do t'i zbatoj germë për germë. Kushtetutën dhe Ligjet, të mira apo të këqija, kështu siç janë, i kanë votuar deputetët e partive tuaja në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka thënë Daka. Ky reagim i kryetares së KQZ-së ka ardhur një ditë pasi nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, ka akuzuar këtë

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 JANAR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka reaguar ndaj akuzave të Lëvizjes Vetëvendosje. Ajo ka thënë se akuzat ndaj saj dhe KQZ-së janë ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e institucionit që drejton. Në një

konferencë për media, ajo ka deklaruar se kërcënimet ndaj saj janë të paprecedente dhe të rrezikshme. "Akuzat e partive politike, në adresë të KQZ-së dhe në adresë time personalisht, janë ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e institucionit, për ta pamundësuar zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Kërcënimet publike ndaj meje

dhe shqetësimet që po i përjeton familja ime - janë të paprecedente dhe të rrezikshme", ka thënë Daka. Ajo ka qartësuar se është ligji dhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese që ua pamundëson disa kandidatëve kandidimin për deputetë e jo ajo. "Të gjithë kandidatëve që dje e kanë parë veten në listën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës si persona





vendosë nëse kanë apo jo të drejtë ato institucione në vendimet që marrin. "Përmbahuni nga fyerjet ndaj institucioneve të pavarura. Nuk i takon politikës të vendosë se a kanë apo jo të drejtë ato institucione në vendimet që marrin. Ne kemi për obligim t'i respektojmë vendimet e tyre. Ne, po ashtu, nesër mund ta krijojmë bazën ligjore dhe kushtetuese në Kuvendin e Republikës, për ta avancuar vendimmarrjen e këtyre institucioneve sipas standardeve më të larta evropiane", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook".

Të papranueshme akuzat ndaj KQZ-së i ka vlerësuar edhe shoqëria civile.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) në reagimin e tij ka kërkuar që Policia e Kosovës t'i hetojë të gjitha kërcënimet eventuale ndaj KQZ-së.

"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme edhe për KQZ-në andaj janë të papranueshme sulmet që i bëhen KQZ-së. Së pari për vendimin për verifikimin e votuesve nga diaspora, kurse tani pse nuk i certifikon kandidatët që janë subjekt i trajtimit në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ta përdorësh këtë si pretekst se KQZ-ja qenka e 'kapur' është pandershmëri e skajshme, aq më parë që KQZ-ja përbëhet nga përfaqësues të subjekteve politike, sipas forcës politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës sikur edhe nga shoqëria civile. KMDLNj kërkon të ndalen sulmet dhe kërcënimet ndaj KQZ-së, anëtarëve të KQZ-së sikur edhe kryetares znj. Valdete Daka në mënyrë që të mos pengohet puna e tyre për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ndërsa Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se partitë politike vendimet e institucioneve të pavarura duhet t'i sfidojnë vetëm përmes rrugëve kushtetuese. "Partitë politike përmes përkushtimit të

Ambasada e Gjermanisë dhe e Italisë presin zgjedhje transparente

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se pret që institucionet e Kosovës ta sigurojnë "organizimin e zgjedhjeve të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente" dhe "në përputhje me standardet ndërkombëtare".

Komenti i tij në "Twitter" ka ardhur në ditën kur kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë, Valdete Daka akuzoi, siç u shpreh ajo, "burrat e politikës" për kërcënime kundër saj. Edhe ambasadori italian në Kosovë,

Nicola Orlando, ka shkruar në llogarinë e vet në "Twitter", se Italia së bashku me BE-në pret që institucionet e Kosovës të sigurojnë zgjedhje të besueshme. "Italia së bashku me BE-në pret që institucionet e Kosovës të sigurojnë zgjedhje të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Procedurat parazgjedhore, sikurse certifikimi i kandidatëve, janë duke vazhduar dhe lejojnë ankesat. Ato duhet të kryhen sipas ligjit dhe pa ndërhyrje", ka thënë ai.



tyre duhet të dëshmojnë se kanë për qëllim respektimin e sundimit të ligjit, duke zbatuar vendimet e instancave gjyqësore dhe institucioneve të tjera respektive dhe jo duke kërcënuar krerët e tyre me fjalorë të papranueshëm. IKD ua rikujton përfaqësuesve dhe partive politike, se kushdo që ka pakënaqësi me vendimet e

institucioneve kushtetuese dhe ligjore, ato mund t'i shprehin vetëm përmes rrugëve kushtetuese dhe ligjore, duke shfrytëzuar mjetet juridike", është thënë në reagimin e IKD-së.


Përmes një komunikate të përbashkët për media, edhe rreth 20 organizata të shoqërisë civile kanë mbrojtur KQZ-në.

institucion se është duke bërë interpretime politike. "Personi i cili në KQZ po ndikon që edhe kërkesa me qenë sugjестive dhe kundër Albin Kurtit është Valdete Daka. Ata asgjë nuk po zbatojnë (KQZ). Po duan eliminim politik", ka deklaruar Konjufca në "RTV Dukagjini". Edhe pas konferencës së Dakës kanë vazhduar kritikën e IV-së ndaj saj. Anëtarë i kryesisë i Lëvizjes Vetëvendosje, Xhelal Sveçla, ka thënë se kryetarja e KQZ-së duhet të "updateohet" dhe ta marrë kalendarin e ri. "Valdete Daka e ka moshën 60 vjeç, mirëpo ajo është një vit e vjetër. Po mendon që ndodhet në janarin 2020 kur ish-presidenti Thaçi i dërgonte letra Albin Kurtit dhe bënte darkë pune me ish-ambasadorin Grenell. Dhe, ndihet e frikësuar mandej. Mirëpo ajo duhet të update-ohet, ta marrë kalendarin e ri: njëmend është muaji janar, por viti është 2021 e jo 2020. Kosova tash ka presidente të re, znj. Vjosa Osmani dhe së shpejti kryeministër të ri, z. Albin Kurti. E kuptojmë që znj. Daka nuk do ta votojë listën Vetëvendosje!, Vjosën më 14 shkurt, por ajo nuk bën që preferencën personale ta keqpërdorë si kryetare e KQZ-së", ka shkruar

Sveçla në profilin e vet në "Facebook".

Qeveria dhe shoqëria civile mbrojnë KQZ-në

Qeveria në detyrë dhe organizatat e ndryshme nga shoqëria civile kanë reaguar pas adresimit të kryetares së KQZ-së se ndaj saj po bëhet presion. Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka ftuar partitë politike që të përmbahen nga fyerjet ndaj institucioneve të pavarura. Sipas tij, nuk i takon politikës të



Mustafa: Urtësia dhe largpamësia e Rugovës na duhen edhe sot

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Në 15-vjetorin e vdekjes së ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, i shoqëruar edhe nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së LDK-së, kanë bërë homazhe te varri i tij në Velani.

Mustafa ka thënë se Rugova me mençuri dhe guxim kishte projektuar qartë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. “Në janarin e acartë të vitit 2006 iku në amshim shkrimtari, studiuesi i letërsisë, lideri dhe presidenti historik dr. Ibrahim Rugova. Intelektuali, politikani i urtë dhe mendimtari i thellë me mençuri dhe guxim kishte projektuar qartë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ai ndërtoi themelet e shtetit tonë mbi parimet: liri, pavarësi dhe demokraci. Sot kujtojmë themeluesin e LDK-së dhe kryetarin e saj të pavdekshëm,

dr. Ibrahim Rugova”, ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se pesha historike e Rugovës është e rëndësishme të veçantë ngaqë, sipas tij, “ai do të mbetet lideri historik që e ndërkombëtarizoi si dhe e bindi botën demokratike që të çlirohet Kosova nga okupimi serb, të themelohet shteti dhe të shpallet pavarësia”.

Lideri i LDK-së ka thënë se Rugova ishte arkitekt i shtetit dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës. “Urtësia dhe largpamësia e tij na duhen edhe sot dhe na ndjekin gjithmonë në rrugëtimin tonë politik. LDK-ja në vazhdimësi ka shprehur zotimin e saj se do të punojë me përkushtim për zhvillimin e vendit, vizion ky i presidentit historik dr. Ibrahim Rugova. Trashëgimia politike që ai la pas është bazament i shtetit të Kosovës. Duke e zhvilluar vendin tonë, duke ruajtur miqësitë e tij që i krijoi në botë, e ruajmë këtë



trashëgimi e cila është emblema më e mirë e Kosovës tonë të sotme dhe të ardhshme. Testamenti politik i Rugovës ishte ruajtja dhe

kultivimi i raporteve me vendet mike dhe përkrahëse të Kosovës, në veçanti siç e thoshte presidenti shumë herë: miqësi e përhershme me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, ka thënë Mustafa, duke shtuar se këtë miqësi LDK-ja do të vazhdojë ta ruajë dhe kultivojë më tutje.

Hoti: ‘Flaka e Janarit’, vlerë kombëtare



GJILAN, 21 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, gjatë vizitës në Gjiilan, në kuadër të manifestimit tradicional “Flaka e Janarit”, është prituri në takim nga kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, i cili e ka falënderuar për mbështetjen që i ka dhënë Komunës së Gjiilanit. Pas takimit, kryeministri Hoti e ka falënderuar kryetarin Haziri për ftesën për të qenë bashkë në kuadër të manifestimeve të “Flakës së Janarit”, që është bërë brend i kësaj komune dhe është vlerë kombëtare që përcillet me interes në mbarë Kosovën. “Ne jemi munduar si qeveri, me

resurset që kemi, të mbështesim projekte në të gjithë sektorët, në të gjitha komunat, pa përjashtim, por rezultatet që kemi arritur në disa prej projekteve në veçanti, janë falë punës suaj, mënyra se si e menaxhoni këtë komunë me një devotshmëri dhe qasje integrale për mbarë regjionin”, ka thënë kryeministri Hoti.

Hoti dha më shumë hollësi rreth Zyrës për Luginën e Preshevës e cila do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. “Tanimë e kemi hartuar edhe një plan pune dhe janë shtrirë obligimet

e të gjitha ministrive, institucioneve, për ta mbështetur Luginën e Preshevës në arsim, shëndetësi, ekonomi, kulturë, rini e sport dhe në të gjitha aktivitetet pa përjashtim, për ta bërë atë pjesë organike të jetës kulturore, ekonomike dhe shpirtërore të mbarë Kosovës”, ka deklaruar Hoti.

Sivjet është edicioni i 30 i manifestimit tashmë tradicional “Flaka e Janarit”, që përbën trashëgiminë shpirtërore dhe shpreh respektin për heronjtë, dëshmorët, martirët dhe të gjithë që kanë dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Bllaca e Suharekës mbështet Limajn për zgjedhjet e 14 shkurtit

SUHAREKË, 21 JANAR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, mbrëmë në Bllacë ka takuar bashkëluftëtarët të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjarë të familjeve të dëshmorëve dhe invalidë të luftës, me të cilët ka biseduar rreth nevojës për t’u bashkuar sa më shumë krahe forcës së tij politike që për qëllim ka të mirën e atdheut. “Në këtë takim, para patriotëve të kësaj zone shpalosa vizionin tonë

për zgjedhjet e 14 shkurtit dhe rëndësinë e madhe që ka rreshtimi i tyre dhe njerëzve të mirë anekënd vendit, në mbështetje të projektit tonë për mbrojtjen e vlerave kombëtare”, ka shkruar Limaj në faqen e tij zyrtare në “Facebook”. Lideri i Nismës në fund të takimit ka falënderuar bashkëluftëtarët dhe qytetarët e Bllacës që po i japin Nismës dhe projektit të tij politik përkrahje të madhe për zgjedhjet e 14 shkurt.



Standardi i partive politike, kandidatët me probleme ligjore



PRISHTINË, 21 JANAR - Subjektet politike të cilat garojnë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë nuk kanë hequr dorë nga mendësia e krijuar me vite, që në listat e tyre të kenë kandidatë që kanë problem me ligjin, vlerëson njohësi i çështjeve juridike, Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. Sipas tij, një gjë tilla u dëshmuar edhe me përgjigjen që Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ku thuhet se nga 28 subjekte politike, që kanë aplikuar për certifikim për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, 15 prej tyre kanë kandidatë të cilët nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Në përgjithësi, sipas KQZ-së, e cila është bazuar në përgjigjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, "janë 47 kandidatë nga rreth 1 080 të cilët janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vjetët e fundit". Ehat Miftaraj thotë për "Radion Evropa e Lirë" se futja në lista zgjedhore të kandidatëve për zgjedhjet e 14 shkurtit është qasje e partive politike që dëshmon mungesën e vullnetit politik për t'u ofruar qytetarëve kandidatë për deputetë apo qeverisje me duar të pastra. "Kjo dëshmon se për partitë politike është shumë me interes që të propozojnë kandidatë qoftë me aktakuza, qoftë që kanë probleme me ligjin, por të cilët në elektorat mund të sjellin vota. Por, në anën tjetër, kjo sjellje e votave automatikisht ndikon në besimin e publikut, në integritetin e kandidatit dhe të

institucioneve, por edhe të vet partisë politike. Në një shtet normal, në një shtet që aspiron të zbatojë standarde minimale të qeverisjes së mirë, të sundimit të ligjit, një qasje e tillë do të ishte e papranueshme. Por, në Kosovë, fatkeqësisht, kjo është ndërtuar standard", theksoi Miftaraj.

Ai shtoi se kjo nuk është hera e parë që partitë politike kanë në listat e tyre zgjedhore kandidatë që kanë probleme me ligjin. Siç thotë Miftaraj, sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme në vitin 2017, për t'u certifikuar kandidat në garën për deputet të Kuvendit të Kosovës, kanë pasur të drejtë edhe personat e dënuar, por edhe ata me aktakuzë. Por, sipas tij, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i dhjetorit të vitit 2020, e ka ndryshuar këtë praktikë dhe ka vendosur standardin e ri, se të gjithë ata që janë të dënuar për vepra penale në tre vjetët e fundit, me vendim të formës së prerë, u kufizohet e drejta për t'u certifikuar kandidat për deputet.

Njohësi tjetër i çështjeve juridike, Florent Spahija nga Instituti Demokratik i Kosovës, në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë", thekson se subjektet politike duhet të veprojnë sipas ligjit që është në fuqi, i cili ndalon kandidimin për të garuar për deputet, të kujtudo që në tre vjetët e fundit është i dënuar, me vendim të plotfuqishëm të gjykatës. "Normalisht që edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë një shtytje ligjit dhe i ka inkurajuar palët që ta zbatojnë atë. Ajo që Gjykata Kushtetuese ka vendosur, po besoj se do të zbatohet edhe nga KQZ-ja, që

ta marrë vendimin (për certifikime) sipas rekomandimeve që janë dhënë nga kjo gjykatë dhe në harmoni me ligjin", theksoi Spahija.

Partitë për dhe kundër tërheqjes së kandidatëve të tyre

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tashmë ka bërë me dije se Zyra për Regjistrim e Partive Politike dhe Certifikim do ta përgatitë rekomandimin për aprovimin apo refuzimin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Këto rekomandime do të paraqiten më pas në mbledhjen e KQZ-së. Vendimin për aprovim ose refuzim, KQZ-ja do ta marrë më së largu deri më 22 janar. Më 3 janar 2018 deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, janë dënuar me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, të enjten komentoj njoftimin e KQZ-së, ku tha se ai është "bartës liste". "Unë jam bartës liste, i cili i respekton dhe i përfill me përpikëri Kushtetutën dhe ligjet të cilët mbrojnë të drejtat e të gjithë neve dhe secilit prej nesh", ka deklaruar Kurti.

Kandidati për kryeministër i Lidhjes Demokratike të Kosovës, aktualisht kryeministër në detyrë, Avdullah Hoti, u ka thënë mediave vendore, se në rast se në listën e tyre ka kandidatë të cilët KQZ-ja i gjen se kanë qenë të shpallur fajtorë për

vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre vjetët e fundit, atëherë ata do të tërhiqen nga lista. "Besoj se të gjithë duhet të trajtohen njësoj, pavarësisht kush janë ata persona. Ligji është i njëjtë për të gjithë dhe të gjithë do t'u nënshtrohen rregullave", ka thënë Hoti.

Ngjashëm kanë thënë edhe zyrtarët e Partisë Demokratike të Kosovës. Zëdhënësi i kësaj partie, Avni Bytyqi, në një përgjigje të shkruar për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se tërheqja e kandidatëve që eventualisht kanë problem me ligjin "është obligim ligjor në këtë rast dhe sigurisht se do të tërhiqen".

Gjykata Kushtetuese, instanca e fundit për apelim?

Vendimi eventual i KQZ-së për të mos certifikuar 47 kandidatë, të cilët sipas përgjigjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vjetët e fundit, mund të kontestohet në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), përmes ankesave të këtyre kandidatëve dhe subjekteve politike të tyre veç e veç. Në rast se këto ankesa hidhen poshtë nga PZAP-i, atëherë ato mund të drejtohen në Gjykatën Supreme të Kosovës. Njohësit e çështjeve juridike shprehin mendimin se edhe në rast se Gjykata Supreme i hedh poshtë ankesat, atëherë këta kandidatë mund t'i drejtohen edhe Gjykatës Kushtetuese.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se

Gjykata Kushtetuese është shkalla më e fundit ku eventualisht mund të drejtohen kandidatët e tillë. "Pas vendimit të Gjykatës Supreme, këta kandidatë kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese dhe ajo gjykatë mund të japë një epilog përfundimtar se çfarë ka dashur të thotë me aktgjykimin e fundit që e ka publikuar dhe në njëfarë mënyre të sqarojë për publikun, por edhe për të gjithë, cili ka qenë qëllimi dhe cilat kategori përfshihen në kufizim për të kandiduar (për zgjedhje) në bazë të vendimit të fundit", theksoi Miftaraj.

Mendim të ngjashëm ka edhe Florent Spahija nga Instituti Demokratik i Kosovës. Sipas tij, shkalla e fundit për apel të një vendimi të KQZ-së, në rast se nuk hidhet poshtë nga PZAP-i dhe më pas nga Gjykata Supreme, është Gjykata Kushtetuese. "Atëherë edhe Gjykata Kushtetuese mund të veprojë në atë mënyrë që të shohë nëse janë shkelur të drejtat e njeriut ose nëse janë në kundërshtim me kapitullin e të drejtave të njeriut, që është e drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta për të zgjedhur. Pra, është një nen i veçantë në Kushtetutë që të lejon të zgjidhesh dhe të zgjedhësh. Kështu që, në këtë kuptim mund të bëhet ankesa në Gjykatë Kushtetuese për 'mohim të kësaj të drejte nga një vendim i një institucioni administrativ'", theksoi Spahija.

Siç kanë sqaruar zyrtarët e KQZ-së, periudha e ankesave dhe vendimit do të përmbyllet më 31 janar, ndërkaq më 1 shkurt do të bëhet tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e këtyre zgjedhjeve.

13.4 milionë euro për hyrjen e Ferizajt me katër korsi

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, bashkë me ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi, kanë marrë pjesë për nisjen e punimeve për zgjerimin e rrugës "Hyrja në qytetin e Ferizajt", investim ky i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kryeministri Hoti ka thënë se ky zgjerim i rrugës krijon qasje më të mirë me komunat përreth, duke lehtësuar edhe të bërit biznes. "Ky është projekt me rëndësi që krijon qasje të mirë për qytetarët e Ferizajt me komunat përreth. BERZh-i, një partner i madh zhvillimor për Republikën e Kosovës, duke financuar shumë projekte infrastrukturore. Ky projekt i akomodon të gjitha nevojat e bizneseve dhe do të përfundohet në afat rekord", ka thënë Hoti.

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka pohuar se me BERZh-in do të ketë edhe shumë projekte të tjera në

infrastrukturë. "Pas një pune të gjatë po fillon një projekt i rëndësishëm që ndryshon edhe pamjen e qytetit, lehtëson lëvizjen e qytetarëve, posaçërisht të bizneseve. Kemi filluar edhe për këtë vit hartimin e projekteve të tjera të cilat i japin formë dhe e lidhin Kosovën me vendet fqinje. Kemi diskutuar me BERZh-in edhe lidhjen e Ferizajt me Brezovicën, nga Peja për në Çakorr, kurse ajo çka është më e rëndësishmja që do ta ofrojmë Kosovën edhe më shumë me Evropën, me autostradën për Merdar që kemi aplikuar për financim. Po këtë vit do ta nisim rrugën me katër korsi, që ka mbetur me vite pezull, autostradën e Pejës (Kijevë - Zahaq)", ka thënë Abrashi.

Ndërsa udhëheqësi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë, Neil Taylor, ka thënë se projekti është i gjatë 5.6 kilometra dhe do të ketë impakt shumë të madh te bizneset dhe njerëzit. Ai ka



theksuar se BERZh-i do të vazhdojë financimin për modernizimin e infrastrukturës

në Kosovë. Projekti parasheh të përfundojë në janar-shkurt të vitit 2023, gjatësia është 5.6

kilometra me katër korsi dhe do ta ketë ndriçimin, trotualet dhe të gjitha standardet.

Parlamenti Evropian kërkon ndaljen e projektit të gazsjellësit rus 'Nord Stream II'



PRISHTINË, 21 JANAR - Parlamenti Evropian pritet të miratojë një rezolutë e cila i bën thirrje Bashkimit Evropian t'i ndalojë ndërtimet në tubacionin "Nord Stream II", i cili do të transportonte gaz natyror rus në Gjermani përmes Detit Baltik. Ligjvënësit po kërkojnë vendosjen e sanksioneve të zgjeruara kundër Rusisë pas arrestimit të liderit të opozitës Aleksei Navalny. Ai u arrestua pas kthimit në Moskë pasi u trajtua në Gjermani për helmim

me një agjent nervor. Rusia ka kundërshtuar thirrjet ndërkombëtare për lirimin e Navalny. Rezoluta jodetyruese kërkon që sanksionet e BE-së të vendosura tashmë ndaj zyrtarëve rusë, përgjegjës për helmimin e tij, të zgjerohen edhe me ata që janë përfshirë në burgimin e kritikut të Kremlinit. Sanksionet duhet t'i përfshijnë gjithashtu "oligarkët rusë", "trethin e ngushtë" të presidentit Vladimir Putin dhe "propaganduesit e

medias", në mënyrë që BE-ja ta bëjë të qartë se "nuk do të jetë më një vend mikpritës për pasurinë ruse me origjinë të paqartë", kërkojnë ligjvënësit evropianë.

Rezoluta thotë se shtetet anëtare të BE-së duhet ta "rishikojnë bashkëpunimin me Rusinë në platforma të ndryshme të politikës së jashtme dhe në projekte të tilla si "Nord Stream II", përfundimi i të cilave duhet të ndalet menjëherë". Ministrat e jashtëm të BE-së pritet të

diskutojnë për këtë çështje javën e ardhshme, por çdo vendim i mundshëm mbase do të merret pas përfundimit të procedurave gjyqësore kundër Navalny. Ekziston një presion në rritje mbi qeverinë gjermane, brenda dhe jashtë vendit, për të ndaluar "Nord Stream II", e cila mundëson dyfishimin e kapacitetit të gazsjellësit ekzistues nënutor Rrjedha Veriore nga Rusia në Gjermani. Qeveria amerikane dhe disa anëtarë të BE-së duan që projekti

të ndalet. Ata thonë se kjo do ta forcojë energjinë e Rusisë në Evropë dhe do ta zvogëlojë rolin e Ukrainës si një vend transit për gazin rus. Më 19 janar Shtetet e Bashkuara sanksionuan një anije ruse për vendosjen e tubave në përpjekjen e tyre të fundit për ta ndaluar projektin i cili është 94 për qind i përfunduar. Pavarësisht prej kritikave në rritje, Ministria e Ekonomisë gjermane tha më 20 janar se planet e saj për projektin janë "të pandryshuara".

AKB-ja me 14 kërkesa ndaj institucioneve dhe partive politike

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 JANAR - Përfaqësuesit e Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), në një konferencë për media mbajtur të enjten, kanë paraqitur 14 kërkesa ndaj institucioneve shtetërore për tejkalimin e krizës ekonomike. Në konferencën me temë "14 kërkesat e AKB-së, bizneseve dhe konsumatorëve deri më 14 shkurt", kreu i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se në bashkëpunim me bizneset kanë përpiluar dokumentin ku do t'i paraqesin kërkesat e tyre. Sipas Shahinit, rritja e shumës së Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, lirimi nga taksat dhe legalizimi i objekteve pa leje janë disa nga kërkesat. "Ne i kërkojmë 14 pika qeverisë dhe partive për tejkalimin e

krizës ekonomike e cila ka ardhur si pasojë e pandemisë. AKB-ja kërkon që të pasurohet Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike si dhe të ketë mbështetje dhe lirim nga taksat. Krejt këto kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik. Këto kërkesa duhet të merren parasysh deri më 14 shkurt. Pra, të hiqen taksat për përpunues vendorë dhe të legalizohen objektet e ndërtruara pa leje deri në fund të vitit 2021. Të falen të gjitha borxhet publike për bizneset dhe qytetarët deri në qershor të vitit 2021. Po ashtu, qeveritë lokale t'i heqin taksat për bizneset, të hiqen ndëshkimet për mjetet për një afat gjashtëmujor, të zhblllokohen llogaritë bankare për të gjithë qytetarët që kanë borxhe për një afat gjashtëmujorë", u shpreh Shahini. Kurse Lumnije



Ajdini nga AKB-ja ka thënë se kanë kërkuar ndryshimin e Ligjit për Prokurim Publik. Nënkrjetari i AKB-së, Suad

Berisha, ka thënë se këto kërkesa janë rruga më e shkurtër që të ndihmohet ekonomia. "Këto 14 kërkesa

janë rruga më e shkurtër, ku Qeveria e Kosovës do të duhej ta mbështeste ekonominë e vendit", ka thënë Berisha.

Një milion euro për kompensimin e dëmeve nga vërshimet në Kosovë



PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Qeveria në detyrë ka marrë vendim për ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve në komunat e dëmtuara nga vërshimet e ndodhura në javën e

parë të janarit të vitit 2021. Në mbledhjen e mbajtur në mënyrë elektronike, kabineti qeveritar ka ndarë 1 milion euro që do të përdoren për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në

objektet e banimit si pasojë e vërshimeve të fundit. "Ministria e Pushtetit Lokal do t'i caktojë kriteret për kompensim dhe do të themelojë komision ndërministror për verifikim,


vlerësim dhe koordinim të procesit të ndarjes së mjeteve nëpër komuna. Sipas vendimit, dëmet në infrastrukturë do të mbulohen nga buxhetet komunale, ndërsa dëmet në

bujqësi do të kompensohen nga buxhetet komunale dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", është thënë në njoftimin e Zyrës së Kryeministrit.

Klubi i Prodhuesve, memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha dhe ministri në detyrë i Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Sipas njoftimit për media,

memorandumi i nënshkruar ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit në mes të Klubit të Prodhuesve dhe MZHR-së, për të kontribuar për zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal në Kosovë. "Synimi i përbashkët



është bashkëpunimi i ndërsjellë, për ta siguruar real-

izimin e aktiviteteve të përbashkëta për avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal, dhe duke përfaqësuar interesin publik midis komunitetit të biznesit dhe autoriteteve publike. Po ashtu, ky memorandum ka për qëllim

shpërndarjen e informacioneve të prodhuesit lidhur me lansimin dhe implementimin e programeve nga MZHR-ja për përkrahje të bizneseve", është thënë në njoftimin për media të Klubit të Prodhuesve.

Rregullohet rryma në Berishë dhe largohet akulli nga rruga në Turjakë

MALISHEVË, 20 JANAR (ER) - Për shkak të reshjeve dhe ngricave në fshatin Berishë janë shkaktuar dëme të mëdha në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe kabllorikut e internetit, ndërsa në fshatin Turjakë, gjithashtu si pasojë e ngricave, është krijuar sasi e madhe e akullit në rrugë, por të dyja këto probleme janë evituar dhe më

nuk ka probleme. Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka qëndruar në këto dy vendbanime dhe është angazhuar në rregullimin e këtyre problemeve. Në fshatin Turjakë është krijuar akull në rrugë si pasojë e ngricave dhe për këtë qëllim, Komuna e Malishevës, është angazhuar për largimin e

akullit dhe pastrimin e rrugës për të krijuar siguri në qarkullim.

Në fshatin Berishë pothuajse në tërësi është dëmtuar rrjeti energjetik, po ashtu edhe shërbimet e internetit dhe kabllorikut, por të gjithë këto probleme janë evituar dhe tashmë banorët e Berishës janë duke u furnizuar me këto shërbime të domosdoshme.



KFOR-i turk ndihmon me pajisje QKMF-në 'Dr. Menduh Kaloshi' në Han të Elezit



HANI I ELEZIT, 21 JANAR (ER) - KFOR-i turk ka ndihmuar me pajisje për analiza të gjakut, urinës, mikroskop, pajisje centrifuguese, të destilimit të ujit, banjë digjitale, kompjuter, printer, tavolina, karrige, dollap për veshmbathje si

dhe shtretër QKMF-në "Dr. Menduh Kaloshi" në Han të Elezit.

Komandanti i Njësisë së Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak i KFOR-it turk, koloneli Serkan Erçakir, ka thënë se në këto ditë pandemie po e kuptojnë

vlerën e shëndetit dhe kjo i ka bashkuar ata në një projekt të përbashkët me qytetarët e Kosovës, veçanërisht ata të Hanit të Elezit. Vlera e investimit është 39.500.00 euro. I gjithë ky investim është financuar nga Republika e Turqisë.

Përurohet salla e edukatës fizike në shkollën 'Dëshmorët e Zhurit'

PRIZREN, 21 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtoresha e Drejtorisë Komunale e Arsimit, Xhemile Thaçi-Vezgishi, kanë bërë përuarimin e sallës së re të edukatës fizike të shkollës "Dëshmorët e Zhurit" në fshatin Zhur. Kjo sallë, që përfshinë një sipërfaqe prej

1.145 metra katrorë, i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive duke përfshirë hapësirë të lojërave sportive, gardërobat, banjat dhe nyjat sanitare për nxënës (femra dhe meshkuj), hapësirën dhe nyjat sanitare për mësuesin si dhe hapësirat për rekuizita.



"Qatar Charity" dhuron 380 pako ushqimore për familjet në nevojë në Podujevë

PODUJEVË, 21 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka prituri në takim Mahmut Abbas, drejtor i përgjithshëm i Organizatës "Qatar Charity", me të cilin u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit.

Gjatë takimit kryetari Bulliqi dhe drejtori i përgjithshëm i "Qatar Charity" nënshkruan marrëveshje për vazhdimin e

bashkëpunimit në disa fusha. Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar "Qatar Charity" do të sjellë donacion 380 pako ushqimore për familjet në nevojë. Me këtë rast kryetari Bulliqi e falënderoi Abbasin për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të organizatës në realizimin e projekteve të ndryshme në Komunën e Podujevës.

Gjithashtu, në takim u bisedua për realizimin e projekteve të tjera gjatë këtij viti nga kjo shoqatë në Komunën e Podujevës.

"Qatar Charity" në partneritet me Komunën e Podujevës do të investojë në shëndetësi, bujqësi dhe çështjen e banimit për familjet në nevojë. Kjo organizatë deri tani ka ndërtuar dy shtëpi banimi për familje me gjendje të rëndë sociale.



Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë bëhet me 'Wifi'



GJAKOVË, 21 JANAR (ER) - Është finalizuar projekti për instalimin e lidhjes me internet 'Wifi' në gjimnazin "Hajdar Dushi" i cili është financuar nga programi i UNICEF-it në Kosovë dhe është mbështetur nga Komuna e Gjakovës. Gjatë lansimit të këtij projekti, kryetari i komunës, Ardian

Gjini, është shprehur tejet mirënjohës ndaj UNICEF-it për mbështetjen e shumë projekteve të rëndësishme për Gjakovën. "Ky investim do të përmirësojë edhe më shumë kushtet e mësimit për nxënësit tanë në këtë shkollë. Është tejet i dobishëm, sidomos në këtë kohë kur po përballemi me Covid-19.

Përmes kësaj qasjeje të avancuar në internet, mësuesin dhe nxënësit do ta kenë më të lehtë procesin mësimor. Uroj që ju nxënës të dashur ta gëzoni këtë projekt dhe të vazhdoni të na bëni krenarë me sukseset tuaja", ka deklaruar Gjini.

Shefi i Zyrës së UNICEF-it në

Kosovë, Murat Sahin, ka thënë se është i lumtur për jetësimin e këtij projekti i cili do të jetë shumë i vlefshëm për këtë shkollë. "Jetojmë në një kohë kur teknologjia është zhvilluar shumë, prandaj përmes këtij instalimi të lidhjes me internet Wifi ju do ta keni më të lehtë procesin mësimor", u shpreh ai.

Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (7)

Për hakmarrje, paraburgosën të gjithë ushtarët shqiptarë që shërbenin në Kazermën e Paraqinit



Lulzim SAHITI

Fill pas rastit të Paraqinit kishte nisur transferimi për gjithë personelin e kazermës, me arsyetimin se ka pësuar trauma. Më 7 shtator 1987 ushtarët shqiptarë i marrin me një autobus nga Garnizoni "Branko Krsmanović" dhe i transferojnë në Kazermën Ushtarake "Stefan Singjeliq" në Nish, nga aty më pastaj i transferojnë në kazerma të tjera të Serbisë. Në shenjë hakmarrje nga data 13-23 shtator 1987, policia ushtarake pa asnjë faj kishte paraburgosur gjashtë ushtarë shqiptarë, një boshnjak-mysliman dhe një rom që shërbenin në Kazermën e Paraqinit:


1. Rizah Xhakli (1967) nga Ferizaj, i paraburgosur më 19.9.1987
2. Abdylxhemil Alimani (1968) nga Bogovina-Tetovë, i paraburgosur më 19.9.1987
3. Afrim Mehmeti (1968) nga Firaja (Shtërpçë), i paraburgosur më 14.9.1987
4. Pajazit Aliu (1966) nga Pakashtica e Epërme (Podujevë), i paraburgosur më 13.9.1987
5. Shefqet Paçarizi (1965) nga Dragobili (Malishevë), i paraburgosur më 14.9.1987
6. Enver Behluli (1967) nga Dobri Do (Gostivar) i paraburgosur më 19.9.1987
7. Rizo Alibashiq (1967) nga Babiqi i Graçanicës (BiH) i paraburgosur më 23.9.1987
8. Islam Mahmuti (1967) nga Gjakova (rom), i paraburgosur më 19.9.1987

Në stilin o tash o kurrë, intelijenca e KOS-it kishte nisur një dramë të jashtëzakonshme duke përdorur ushtarët shqiptarë si kurban për ta kurdisur Procesin e Paraqinit. Për këtë duhej të bëhej arrestimi i të gjithë ushtarëve shqiptarë të Kazermës së Paraqinit, përpos atyre që fatbardhësisht nuk ishin atë natë brenda kazermës. Disa prej tyre arrestohen mu në ditën kur duhej ta përfundonin shërbimin ushtarak njëvjeçar. Brenda dhjetë dite dikush më herët e dikush më vonë u burgosën tetë ushtarë të rinj, të cilët as vetë nuk e dinin pse po arrestoheshin. Të gjithë i dërguan nëpër qelitë skëterrë të Burgut Ushtarak të Nishit, ku vinte vetëm erë vdekje. Faji i vetëm i tyre ishte vetëm pse ata janë shqiptarë. Burgosja e tyre do të mbetet fund e krye një turp i madh i krerëve të KOS-it jugosllavë, të cilët gjatë hetimeve me muaj të tërë duke përdorur dajakun bën sajimin e akuzave me metoda të tmerrshme të dhunës të ushtruar ndaj

rekrutëve të rinj shqiptarë. Në burgun hetues të Nishit, gardianët me sy gjarpërinjsh dhe drejtori i tyre, Stanko me shpirt kriminel, ushtronin dhunë e terror si xhelat ndaj shqiptarëve të përvuajtur saqë është e pakapshme për trurin dhe mendjen e shëndoshë të njeriut se si ka mundësi që njeriu-njeriut t'i shkaktojë kaq shumë dhimbje e vuajtje shpirtërore. Gjatë netëve të gjata pa gjumë dhe ditëve skëterrë me muaj të tërë, të akuzuarit e pafajshëm shqiptarë nuk kanë ditur se çka të deklaronin për diçka që nuk ishte bërë nga ta, por për të mbetur gjallë ata është dashur të sajnin e trillonin duke dhënë deklarata të rrejshme ashtu siç kërkonin inspektorët e sigurimit ushtarak. Vërtet për këta tetë ushtarë të mbyllur nëpër qelitë e burgut pa ajër dhe dritë të mjaftueshëm ishte bërë tmerr e hata duke ju fyer atyre përditë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat më elementare njerëzore. Çdo ditë janë rrahur me shkopinje gome, grushte, shqelma... me të vetmin qëllim që t'i thyenin shpirtërisht dhe të pranonin akuzat të rreme dhe të akuzonin vetveten dhe të tjerët me të pavërteta.

Rrëfimi i dëshmitarëve për ngjarjen e Paraqinit

Si ndodhi ngjarja e papritur në natën e 3 shtatorit 1987, tregon dëshmitari i rastit në fjalë, ish-rekruti Rizah Xhaklinga Ferizaj: Kam dëgjuar të shtëna të ndërprera të automatikut por më është dukur që jam në ëndërr dhe pas pak është hapur dera e dhomës tonë ku flinim. Është ndezur drita dhe një nga ushtarët e dhomës ka bërë thirrje "Uzbuna" (Alarm)! U zgjova dhe filloi rafali edhe te ne. Unë fytyrën e personit që ka shtënë nuk e kam parë sepse kam qenë duke fjetur në skaj të dhomës. Dera ka qenë në mes, kurse shtretërit ishin dykatësh. Unë kam fjetur, në katën e dytë të shtretit, kurse nën shtretin tim ka fjetur Islam Mahmuti. Gjatë të shtënave, unë dhe Islami jemi futur nën shtretin tonë, kur pas një intervali shumë të shkurtër kohor, nën shtretin tonë ka ardhur rrëshqitazi ushtari Nikola Vidović, që ka qenë prej rrethit të Novi Sadit. Ndodhën krismat, britmat, qarjet... Nuk e dija njëherë çka u bë? Mendova se po japin alarm me të shtëna, i pashë gëzhojat që nuk




ishin të municionit shkollor. Gjithashtu të shtrirë e pashë ushtarin Hasim Gjananović, i cili vdiq pas pak kohe. I plagosur në këmbë kishte mbetur, Huso Kovaçević, të cilin e pyeta: "Çka u bë?". "Ai vendasi yt shtiu", përgjigjet Kovaçević. E pyes tjetrin, të njëjtën përgjigja mora: "Ai vendasi yt". Në dhomën time të plagosur ishin edhe rekrutët: Andrej Presheren dhe Petar Gjekić. Në rrethanat e krijuara prej frike nga dritarja ka kërcyer ushtari Nazif Axhović, shqiptar nga Tuzi i Malit të Zi, i cili asnjëherë nuk fliste në gjuhën amtare dhe prezantohej si mysliiman. Në momentin e parë kam dalë në korridor. Aty kishin dalë edhe ushtarët tjerë, të cilët qanin e britnin. Ishte diçka e papritur! Ushtarët shqiptarë ishin të shqetësuar por asnjë nuk qante. Në dukje ndjeheshin të frikësuar kur morën vesh se çka u bë dhe kush e bëri? Tash mendonin çka do të bëhet me ne sepse kishin parandjenjë të keqe. Kam shkuar në dhomën tjetër ku flinin Shefqet Paçarizi dhe Pajazit Aliu. Aty pashë tre ushtarë të vdekur. Në anën e djathtë të dhomës ka qenë Safet Dudaković nga Bosnjë-Hercegovina, përballë derës Srgjan Simiq nga Serbia dhe në anën e majtë Goran Begiq nga Kroacia. Në këtë dhomë kishin mbetur të plagosur Ante Jazhiq dhe Nexhid Mehmedović. Ndërkohë në pavijon ka ardhur Alibashiqi i


frikësuar dhe ka shpjeguar duke quajtur se si kishte shkuar Azizi te tenda e tij duke ju kërcënuar me armë dhe ia kishte marrë municionin. Dikur filloi veç të zdritet dhe nisën të vijnë eprorë e policë ushtarakë nga anë të ndryshme. Neve na dërguan në dhoma të mësimit, ku në mbrëmje zakonisht shkonim ndonjëherë për të këqyrë televizorin. Kah ora 8:00 një ushtar po thotë se po të thërret oficeri. "Hajde me shkuar me marrë ushqimin" më thotë oficeri në fjalë. Unë, oficeri dhe një ushtar i kuzhinës u nisëm për në Çupri. Gjatë gjithë rrugëtimit tonë ka pasur kontrollime të hatashme nga policia ushtarake dhe civile. Ishte hera e parë dhe e fundit që unë dola nga Kazerma sepse me atë ditë që unë e mora mëngjesin kur u ktheva mi morën çelësat. Madje kur kemi hyrë në kazermë, na kanë bastisur edhe pse kamionin ishte me tabela ushtarake. E morëm ushqimin bashkë me oficerin, i cili trallë herë vinte me mua, kurse për ta shpërndarë atë në dy vendet e rojës nuk vinte asnjëherë. Mirëpo, atë ditë erdh së bashku me mua. Ndërkaq, kur erdh koha e drekës për të shkuar me marrë sërish ushqimin, po më thërret oficeri dhe më thotë: "Mi jep çelësat. Ia dhashë dhe kurrë më nuk më dhanë kamionin për të vozitur. Dikund pas dreke, kufomat e ushtarëve të vrarë i futnin në një kamion ushtarak "Dajc" për t'i dërguar në Spitalin Ushtarak të Nishit për obduksion. Po e shoh një kufomë, të cilën refuzonin ta bartin ushtarët serbë dhe të nacionaliteteve tjera. Unë nuk e dija njëherë se ishte trupi i pajetë i të ndjerit, Aziz. Me këtë rast, e kuptova se për kënd bëhet fjalë. Jam afruar dhe e kam kap lesën te koka duke e ngritur për ta ngarkuar në kamion. Trupi i të ndjerit ishte i mbuluar me çarçaf të bardhë dhe e pashë një pjesë të trurit të kacavjertë mbi çarçaf. Atë ditë ka nisur marrja në pyetje për të gjithë ushtarët e kazermës tonë.

Realisht pyetjet ishin të rëndomta: "Ku kenë qenë, çka ka ndodhë, çka kenë parë...?" Pra, gjithçka bëhej në mënyrë të mirë e të çetë. Gjatë kësaj dite, erdhi një kapiten shqiptar që quhej Xhavit Teneqja nga ana e Kaçanikut. Edhe ky nisi të më merr në pyetje! Filloi të më provokoj, maltretoi por jo fizikisht. Më bënte fyerje të ndryshme, unë rrija gatitu, ai qëndronte ulur dhe më thoshte: "Mos e shiqo Titon se me pas dashur ju Titon nuk e kishi bërë këtë. Pse e kenë bërë këtë, s'kenë lexuar historinë jugosllave por kenë mësuar për Naim Frashërin - "Bagëti e Bujqësinë"! Çka ju kanë nevojitur ato gjëra?". Kështu na bënin maltretime të tilla që nuk ka pasur nevojë të bëhen fare por ky i bënte, bashkë me oficerët e tjerë jugosllavë, tregon ndër të tjera Rizah Xhakli. Abdylxhemil Alimani nga fshati Bogovinë i Tetovës tregon se natën kritike, më 3 shtator të vitit 1987, kam qenë në vend rojës numër 1 prej orës 2:00 - 4:00 të mëngjesit, ndërkaq në vend rojës numër 2 ishte Shemsudin Selimović. Dikund pas orës 2:00 të natës, Aziz Kelmendi kishte ardhur i paarmatosur te mësonjëtorja dhe kishte hyrë nga dera brenda. Kur më pa se jam në rojë, doli nga dritarja. Po e pyes: "Çka po lypë në dhomën e mësimit? Azizi u përgjigj: "Jam sonte kujdestar dhe dola me marrë diçka për të lexuar por nuk gjeta asgjë". Ai u kthye në kazermë pa e zgjatur më shumë. Ndërkohë, të shtënat ndodhën në ora 3 e 5 minuta, kështu rastisi që në atë kohë unë të gjendem në rojë e kazermës. Unë e kam pas vështirë t'i vërej lëvizjet te kazerma gjatë natës, pasi kam qenë në rojë dhe kam qenë i kufizuar në lëvizje. Vendi i ngjarjes ka qenë larg rreth 200 metra nga vendi im i rojës, ku kam mundur të dëgjoj vetëm krismat. Kur dëgjova rafalët, kam tentuar që përmes telefonave ushtarakë të vë lidhje me komandantin e rojës, dhjetarin Rizo Alibashiq, por pa sukses.

(Vijon)



Iustrim i Burgut Ushtarak të Nishit në formë të skicës



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Trepça triumfon kundër Prishtinës, Ylli vazhdon me fitore



PRISHTINË, 21 JANAR - KB Trepça ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës në udhëtim me rezultat 75:79 (14:15, 22:21, 17:22, 22:21), në kuadër të javës së 16-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Ndashja ishte shumë interesante nga fillimi deri në fund. Çereku i parë ishte i baraspeshuar dhe përfundon 14:15 në të mirë të mysafirëve. Edhe periudha e dytë ishte mjaft e barabartë dhe përfundon 22:21 për vendasit dhe skuadrat shkuan në pushim me shifrat 36:36. "Bardhekaltrit" e filluan më mirë periodën e tretë, duke pasur epërsi në shtatë pikë, 47:40, por mitrovicasit nuk dorëzohen dhe kalojnë në epërsi 49:52, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 43:48. 10 minutat e fundit ishin mjaft dramatike. Trepça kishte epërsi

deri në 17 pikë, 57:74, por prishtinasi me një seri prej 18:0, kalojnë në epërsi 75:74. Koljeviq me pesë pikë në fund ishte vendimtar dhe hero në fund, ku Trepça triumfon në fund 75:79. Tani të dy skuadrat kanë nga katër fitore dhe 12 humbje. Te Sigal Prishtina u dalluan Daniel Lekndreaj me 31 pikë e gjashtë kërcime, kurse te Trepça më i miri ishte Ivan Koljeviq me 21 pikë e gjashtë kërcime. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Bashkimit me shifrat 96:73 (25:19, 21:28, 23:16, 27:10), në kuadër të javës së 16-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Ndashja nisi e baraspeshuar dhe pas rezultatit 11:11, Ylli ishte më i mirë, duke fituar çerekun e parë 25:19. Edhe periudha e dytë ishte e barabartë në fillim, por më pas mysafirët morën lojën në dorë dhe

barazuan rezultatin në 34:34, dhe deri në fund të pjesës së parë, skuadrat nuk arrinin të shkëputeshin në rezultat dhe pjesa e parë përfundon 46:47. Vendasit e filluan furishëm pjesën e dytë, përkatësisht periudhën e tretë, duke e fituar këtë pjesë 23:16, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 69:63. Therandasit ishin edhe më bindës në 10 minutat e fundit, duke fituar 27:10 për të triumfuar në fund 96:73. Te Golden Eagle Ylli u dallua Mitchell Wilbekin me 25 pikë e gjashtë asistime dhe Samir Zekiqi me 23 pikë e shtatë kërcime, kurse te Bashkimi u dallua Endrit Hysenagolli me 24 pikë e 15 kërcime. Golden Eagle Ylli ka dhjetë fitore dhe gjashtë humbje, kurse Bashkimi tetë fitore dhe tetë humbje.

SHKURT

Vëllaznimi përforcohet me Avdylin

Skuadra e Vëllaznimit është përforcuar me mesfushorin Granit Avdyli, i cili gjatë karrierës futbollistike ka luajtur për shumë skuadra përfshi edhe Besën e Pejës. "Granit Avdyli është përforcimi i radhës. Avdyli është mesfushor i cili ishte pjesë e KF Dukagjini, KF Besa dhe së fundmi ishte pjesë e KF Onix", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga Gjakova. Vëllaznimi bën pjesë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll dhe vitet e fundit është duke u përballur me një krizë të madhe financiare.

Gjilani zhvillon miqësore ndaj FC Deçiç

Skuadra e Gjilanit po vijon përgatitjet në qytetin bregdetar të Shqipërisë në Durrës. Në kuadër të këtyre përgatitjeve, kuq e bardhët do të zhvillojnë edhe një ndeshje testuese, ku këtë herë për kundërshtar do ta ketë skuadrën nga Tuzi i Malit të Zi, FC Deçiç, skuadër e cila garon në elitën e futbollit malazez dhe pozicionohet e dyta në tabelë pas përfundimit të gjysmësezonit të parë. Ndashja Gjilani-Deçiç do të zhvillohet sot (e premte), me fillim në ora 13:00 dhe zhvillohet në qendrën sportive Olimpik Park në Durrës.

Islami rikthehet pas shtatë muajsh

Futbollisti i njohur në futbollin e Kosovës, Përparim Islami është rikthyer pas shtatë muajsh. Në fakt Islami vuajti nga një lëndim i gjatë, derisa ai është rikthyer duke u inkuadruar në pjesën e dytë të ndeshjes miqësore të cilën skuadra e Feronikelit e zhvilloi ndaj Strugës në "Olimpik Resort". Kjo ndeshje përfundoi 1-1, derisa Islami do të jetë një "armë" shtesë për trajnerin Klodian Duro në sezonin pranveror.

Bare kushton 10 milionë euro

Keidi Bare e kishte të vështirë fillimin te Espanyoli, pasi vuajti disa probleme burokratike, ndërsa më pas një dëmtim. Por ai është kthyer edhe është një nga lojtarët më të rëndësishëm të skuadrës katalanase e cila për momentin kryeson renditjen në La Liga 2 me 45 pikë pas 21 ndeshjesh dhe ka shanse të mëdha për t'u rikthyer në La Liga. Me paraqitjet e mira Bare ka tërhequr vëmendjen e klubeve të ndryshme, nga La Liga dhe Serie A. Sipas faqes "La Grada" në Spanjë, çdo klub që e do Baren do të duhet të paguajë 10 milionë euro.

Lojërat Olimpike do të zhvillohen, por pa praninë e publikut

Drejtori Ekzekutiv i komitetit organizues të "Tokyo 2020", Toshiro Mutu, siguroi se anulimi i Lojërave Olimpike (23 korrik deri më 8 gusht) për shkak të pandemisë nuk ishte nën diskutim, por pranon mundësinë që ato të zhvillohen pa audiencë. "Ne nuk jemi duke diskutuar anulimin. Mbajtja e Lojërave Olimpike është politika jonë e palëkundur", ka thënë Mutu, duke zbuluar mundësinë që gara të mbahen me dyer të mbyllura. "Konkluzionet e arritura në pranverë janë diçka që ne do t'i zbulojmë më vonë. Nuk mund të bëj asnjë parashikim", ka shtuar Mutu.

Domenicali: Formula 1 ka nevojë për Ferrarin që të mos dështojë si sport

Stefano Domenicali, presidenti i ri i Formula 1, ka deklaruar se ky sport ka nevojë që Ferrari të jetë kompetitiv, pasi dominimi i Mercedes po sjell një krizë në shikueshmëri.

"Kemi të gjithë nevojë për Ferrarin, që të rikthehet të garojë për to", ka thënë Domenicali, që dikur ka qenë drejtori sportiv i makinës italiane. "Kjo gjë nuk ka për

të qenë e lehtë për kokëkuqen, por jam i bindur se situata do të ndryshojë. Një makinë Ferrari kompetitive do të rikthejë spektaklin në pistë, tifozët në tribunë,

shikueshmërinë në televizion, të ardhurat. Pra, gjithçka varet nga Ferrari, që ky sport të mos dështojë dhe të zhgënjë me spektaklin e tij", ka deklaruar Domenicali.

Ronaldo: Superkupa e rëndësishme, synojmë edhe titullin

TORINO, 21 JANAR - Juventusit e ka fituar Superkupën e Italisë pas fitores 2-0 me Napolin. Golat e fitores u realizuan nga Cristiano Ronaldo dhe Alvaro Morata në pjesën e dytë, teksa Andrea Pirlo shijoi trofeun e

parë si trajner. "Ishte një ndeshje shumë e vështirë në një fushë të keqe. Ia dolëm të fitojmë Superkupën, një trofe i rëndësishëm sidomos në aspektin e besimit që do të injektojë te skuadra", ka thënë

Ronaldo. "Seria A? Milani dhe Interi janë shumë të fortë, por ka edhe shumë ndeshje deri në fund të kampionatit. Ne mund ta fitojmë titullin. Do të jetë një betejë e madhe, por kemi shanset tona. Kemi

pasur një qëndrim ndryshe në krahasim me ndeshjen kundër Interit, ndaj të cilëve luajtëm shumë keq. Skuadra luajti keq, por tashmë kaloi ajo ndeshje", ka deklaruar Ronaldo.



Distria nga shtatori i 2018-s ka fituar medalje në çdo garë

PRISHTINË, 21 JANAR - Botërori i Bakus, i mbajtur në muajin shtator të vitit 2018, është gara e fundit ndërkombëtare në të cilën xhudistja e Kosovës, Distria Krasniqi, nuk është ngjitur në podium. Që nga atëherë në të gjitha garat ku ka marrë pjesë, xhudistja pejana ka fituar medalje. Bilanci i saj është shtatë medalje të arta, tri të argjendta dhe tri të bronzta. Ajo ndodhet e para në renditjen botërore dhe



olimpike të kategorisë deri në 48 kg, ndërsa kjo vazhdimësi synohet të vazhdohet edhe në vitin e Olimpiadës 2021.

GARAT KU KA FITUAR MEDALJE NË TRE VJETËT E FUNDIT:

2018	Kampionati Botëror Tokio - medalje e bronzit
	Masters Qingdao - medalje e artë
	Grand Slam Abu Dhabi - medalje e argjendit
	Grand Prix Tashkent - medalje e artë 2020
	Grand Prix Haga - medalje e bronzit
	Guangzhou Masters - medalje e artë
2019	Grand Slam Paris - medalje e artë (-52 kg)
	Grand Slam Budapest - medalje e artë
	Kampionati Evropian Prag - medalje e bronzit
	Grand Slam Paris - medalje e argjendit 2021
	Grand Prix Antalia - medalje e artë
	Grand Prix Budapest - medalje e argjendit
	Masters Doha - medalje e artë

Mandzukiqi: Unë dhe Ibra do t'i frikësojmë të gjithë

MILANO, 21 JANAR - Mario Mandzukiqi është prezantuar te Milani në një konferencë të gjatë për shtyp ku ka prekur shumë tema. Sulmuesi kroat i ka cilësuar të rinjtë e Milanit si luftëtarë. "Isha duke u përgatitur për këtë mundësi prej disa kohësh. Ka një atmosferë të mirë në Milanello. Milani po bën një punë të shkëlqyer, duke qenë të parët në renditje. Dua të jem gati menjëherë për ta ndihmuar ekipin. Është një ekip i ri, por të gjithë janë luftëtarë të rinj. Gjithkush bën punën e tij. Unë jam një profesionist që gjithmonë jep gjithçka. Nëse të rinjtë më ndjekin unë jam i lumtur", ka thënë Mandzukiqi. "Jam stërvitur fort gjatë muajve të fundit. Nëse nuk do të ndihesa i gatshëm nuk



do të kisha pranuar të vija në një klub të shkëlqyer si Milani. Pa dyshim që do të më duhen disa ditë për t'u njohur me shokët e mi të skuadrës, por unë jam i gatshëm ta jap kontributin tim kur trajneri më thërret. Unë dhe Ibra do të japim përvojë dhe do t'i frikësojmë të gjithë", u shpreh Mandzukiqi.

SHKURT

Marquezi, pas tri operacioneve i rikthehet stërvitjeve

Lajme të mira vijne për Marc Marquezin, tetë herë kampionë bote në garat e motoçiklizmit. Piloti spanjoll i Hondas është rikthyer në palestër 48 ditë nga operacioni i fundit në shpatullën e majtë. Gjatë vitit të kaluar ai u operua tri herë brenda pesë muajsh, duke mos zbritur në pistë përgjatë gjithë sezonit (garoi dhe u rrëzua në garën e parë sezonale). Gjithsesi, Marquezi mban ende një mbrojtëse krahu teksa bën palestër. "Dita e parë e stërvitjes, disa pedalime në biçikletë në një palestër të mbyllur", shkruan Marquezi në rrjetet sociale, që gjatë gjithë këtyre ditëve ka qenë në pushim absolut. Gjithsesi, pavarësisht prej rikthimit në palestër, ende nuk ka një datë të saktë se kur Marquezi do të rikthehet në pistë. Mendohet se ai do të mungojë në garat e para sezonale dhe do të ketë mundësi të garojë sërish duke nisur nga maji 2021.

Zidane: Nuk është turp eliminimi nga Alcoyano

Nëse trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, do të shpëtojë këtë herë, do të jetë një mrekulli. Ai nuk e konsideron turp eliminimin nga Kupa e Mbretit, por thotë se gjëra të tilla mund të ndodhin në futboll. "E di që luanim ndaj një skuadre inferiore dhe duhet të fitonim, por nuk është turp. Futbollit është fillë dhe ka surpriza. Mund të ndodhin gjëra të tilla në futboll dhe në karrierën e një trajneri ka surpriza. Unë jam përgjegjës për këtë. Do të marr përgjegjësi sepse djemtë dhanë gjithçka në fushën e lojës dhe u përpoqën që të kualifikoheshin. Duhet ta urojmë rivalin për ndeshjen që bëri. Tani të punojmë për t'u përmirësuar në ndeshjet në vijim. Shkarkimi? Të ndodhë ajo që duhet të ndodhë", ka thënë Zidane.

Ribery: Mund të rikthehem në Bundesliga

Ish-ylli i Bayern Munchenit, Franck Ribery, ka lënë të kuptohet se është i hapur për t'u kthyer në Bundesligë, edhe pse theksoi se tani për tani është i përqendruar te Fiorentina. Kontrata e Riberyt me Fiorentinën mbaron në fund të këtij sezoni dhe, edhe pse 37-vjeçar, Ribery nuk e ka ndërmend të ndalet. "Tani për tani po mendoj vetëm për Fiorentinën. Jam i rëndësishëm për këtë ekip. Por nuk e hedh poshtë kthimin në Bundesligë kur të mbaroj punë këtu", ka thënë Ribery.

Aguero infektohet me Covid

Sulmuesi i Manchester Cityt, Sergio Aguero, ka dalë pozitiv në testin për koronavirus dhe tashmë është vetizoluar pas kontaktit të ngushtë me një person tjetër që kishte Covid. Sulmuesi argjentinas, pas rikthimit nga lëndimi, është konfirmuar se është infektuar me koronavirus. "Pas një kontakti të ngushtë unë kam qenë i vetizoluar dhe testi i fundit që kam bërë ishte pozitiv për Covid-19. Kam pasur disa simptoma dhe po ndjek urdhrat e mjekut për shërim. Kujdesuni, të gjithë!", ka shkruar Aguero në profilin e tij në "Twitter".


Pirlo: Si trajner është më bukur të fitosh trofe

Andrea Pirlo i gëzohet trofeut të tij të parë si trajner. Pas triumfit në Superkupën e Italisë, trajneri i bardhezinjve ka thënë se është më bukur të fitosh si trajner sesa si

futbollist. "Ndiej gëzim të madh. Ngritja e trofeut tim të parë si trajner është ndryshe. Mendoj edhe më mirë sesa si lojtar, sepse po drejtoj një skuadër kaq të mrekullueshme dhe në një klub historik.

Është e mrekullueshme. Është e rrallë që dy skuadra luajnë mirë në një finale, gjëja e rëndësishme është të fitosh. Kur luan me këtë vendosmëri, atëherë fati mund të shkojë në anën tënde. Ne

donim të provonim se nuk jemi skuadra e javës së shkuar kundër Interit, kështu që kur luan me këtë grintë, vendosmëri dhe qëndrim, fati vjen në rrugën tënde", ka thënë Pirlo.





Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejepuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ N.N. "Andi" shpall të pavlefshme certifikatën e nr. fiskal me nr. 600081195 si dhe certifikatën e TVSH-së, me nr, 330072801.
- ▶ Fjolla Berisha shpall të pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu " Mati Logoreci " Prizren
- ▶ Zeqir Avdija shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Selvet Shala shpall të pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu " Mic Sokoli " Leskovec.
- ▶ Qendrim Hoti shpall të pavlefshme 3 deftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377




AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kiesłowski』

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIESŁOWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

